



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4236 /2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e pestë -V- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 30.05.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.
3. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i komunës së Hanit të Elezit.
4. Plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës.
5. Rishqyrtimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave.
6. Plotësim-ndryshimi i vendimit nr 01/Nr.1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.
7. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
8. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e Draft Strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.
- Materialin e draft planit të veprimit për Transparencë 2023-2026 i komunës së Hanit të Elezit.
- Materialin e plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës.
- Materialin e rishqyrtimit të vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave.
- Materialin e plotësim-ndryshimit të vendimit nr 01/Nr.1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.
- Materialin e informatës mbi mbrojtjen e mjedisit.

Hani i Elezit
Data:-22.05.2023



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4237/2023
Data: 16.05.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katër -IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.04.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.
3. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Kërkesa e znj. Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rregullta të rendit të punës të cilat i kemi përcjell kemi edhe një pikë të rendit të ditës të cilën propozoj që të hynë në rend të punës, Propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë” 2023 në Komunën e Hanit të Elezit. Raporti i komisionit komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Hapi diskutim për pikat e rendit të punës.

Sherif Berisha thekson:- në komitet për politik e financa i kemi shqyrtuar katër apo pesë pika të rendit të punës kurse në kuvend janë bërë afër dhjetë pika. Materialet po dërgohen me vonesë dhe materiali duhet të përcillet me kohë në mënyrë që si asamblistë të përgatitemi për pikat e rendit të punës. Kemi bërë kërkesë që mos të hyjnë pikat e rendit të punës në këtë formë por të shqyrtohen në KPF dhe të përcillen për kuvend. Vërejtje për këtë çështje keni si kryesuesi i kuvendit së bashku me të tjerët.

Zaim Bela thekson:- pika shtesë e rendit të punës për çështjen e kompensimit të dëmeve a duhet që të miratohet në kuvend dhe komuna me i kompensuar. Me sa e di unë komisionin e formon drejtoria e bujqësisë e jo drejtoria e shërbimeve publike. Komisioni e bënë vlerësimin dhe kërkesa dërgohet në Ministri përkatëse për kompensimin e dëmit.

Abduraman Bushi thekson:- kur janë shkaktuar dëmet në muajin shkurtë e kam përgaditur lëndën sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Bujqësisë por kur i kam dërguar në Ministrinë përkatëse , mirëpo Ministria i ka kthyer dhe ka rekomanduar se nga një janari këtij viti për kompensimin e dëmeve nuk merret Ministria e Bujqësisë por një komision ndër ministrorë i formuar nga zyra e Kryeministrit që është pjesë e agjensionit të emergjencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Procedurat i kemi zhvilluar sipas rregullores dhe e kemi përcjell në këtë formë në kuvend.

Hisni Luri thekson:- kemi planifikuar me mbajtur festivali dhe për atë e kemi përcjellë në këtë formë.

Kryesuesi thekson:- sa i përket vërejtjes që u dha për çështje të materialeve keni të drejtë. Mund të arsyetohet drejtori i bujqësisë për shkak se ka kërkuar Ministria por drejtoria e arsimit është dashur me kohë ta procedon por pasi që janë ditët e kulturës kërkoj që edhe kjo pikë të hynë rend të punës. Drejtoritë duhet të jenë më të arsyeshëm kur ta paraqesin ndonjë material në ditën e mbledhjes. A keni edhe ndonjë diskutim për rendin të punës, nëse nuk ka i hedh në votim pikat shtesë ; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Kërkesa e znj. Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.
6. Raporti i komisionit komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
7. Propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë” 2023 në Komunën e Hanit të Elezit
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2023 është në shumë prej 3,349,715.00 €, në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 438,190.62 € apo 25.73 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 56,767.57 € apo 12.21%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 20,428.74 € apo 21.17 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 3,400.00€ apo 3.40 %, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 2,540.00 € apo 0.26 % . Totali i shpenzimit për periudhën Janar -Mars të vitit 2023 është në shumë prej 521,326.93 € apo 15.56%. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 43,749.54 € të hyra vetanake për periudhën janar-mars 2023 të planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi një rënie në shumë për 21,495.36 €.

Zaim Bela thekson:- faqe tre është një gabim teknik krahasimi i vitit 2022 me vitin 2023 për shkak se ke bërë diferencën mbi 60 000 € . Pagat dhe shtesat në këtë vit është në shumë prej 1 702 000 € ndërsa vitin e kaluar ka qenë 1756 000 €, kërkoj sqarim.

Lindita Ballazhi thekson:- çështjen e shumës që u përmend do ta kontrolloj sepse ka mundësi që mund të jetë ndonjë gabim teknik . Në kategorinë e pagave dhe shtesave kemi një ulje të cilën vetë e kemi kërkuar nga Ministria sepse në çdo vit ka shkuar në suficit kategoria e pagave dhe kemi kërkuar që të na rriten kategoritë e tjera buxhetore .

Sherif Berisha thekson:- në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kemi rritje në përqindje prej 17.24 % kërkoj sqarim të dijes se pse është bërë kjo rritje. Në kategorinë mallra dhe shërbime në cilat drejtori është shpenzuar dhe për çfarë shpenzime bëhet fjalë, kategorinë ekonomike shërbime komunale cila drejtori ka shpenzuar shumë prej 8448 €. Shpenzimet e buxhetit për këtë tre mujorë investimet kapitale janë shpenzuar prej 0.26 % e mjeteve të parapara në buxhet dhe a mendoni që në nëntë mujorin që ka mbetur do të bëhet shpenzimi i buxhetit. A do të dëmtohem nëse bëhet falja e mjeteve financiare prej 100 € nga Ministria.

Lindita Ballazhi thekson:- shpenzimi më i madh në kategorinë e pagave ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit të pagave . Nëse krahasohet me tre mujorin e vitit 2022 shpenzimi është më i madh për shkak se në vitin e kaluar kemi pasur një alokim të buxhetit shumë më vonë, ndërsa në këtë vit prej muajit janar kemi filluar me ekzekutim të buxhetit . Shpenzimet komunale i ka administrata komunale , shkollat çerdhja si dhe sektori i shëndetësisë dhe duhet ta kemi parasysh se çmimet janë rritur . Shpenzimet kapitale ka të bëjë me një shpronësim por ende nuk kemi kryer ndonjë pagesë për projektet kapitale . Sa i përket shumës prej 100 € ende nuk kemi ndonjë informacion nga Ministria për këtë çështje dhe nëse kjo miratohet do të preken te investimet kapitale .

Refet Kalisi thekson:- shpenzimet për karburante në këtë vit janë në shumë prej 5131 €, ndërsa vitin e kaluar ishin zero zero. Te mirëmbajtja e rrugëve janë shpenzuar mjete financiare në shumë prej 7730.00 € por në këtë vit nuk kemi pasur të reshura të borës . Te shpenzimet kapitale janë në shumë prej 985 000 € dhe mbi 500 000 € i kemi prej të hyrave vetanake dhe a do të kemi mundësi që me i inkasuar këto mjete në mënyrë që mos me dështuar në projekte kapitale .

Lindita Ballazhi thekson:- vitin e kaluar shpenzimet për karburante ishin zero zero për shkak se alokimi i buxhetit ka qenë me vonesë dhe ekzekutimi i pagesave ka filluar me vonesë ndërsa në këtë vit është ndryshe sepse kemi filluar në muajin janar. Sa i përket rrugëve me bor ndoshta nuk ka pasur por shërbimet janë kryer dhe drejtori përkatës ndoshta mund të u jep sqarime më saktë. Sa i përket investimeve kapitale që u potencua shuma mbi 500 000 € nuk qëndron ashtu sepse vlera totale e investimeve kapitale për këtë vit është 985 392 € ku prej tyre 57 6471 € janë prej grantit qeveritarë të cilat janë mjete të sigurta , ndërsa prej të hyrave i kemi 408 921 € dhe do të bëjmë çmos për me i inkasuar këto mjete financiare edhe pse ndoshta të gjitha nuk mundemi me i inkasuar po të paktën 80 % me i inkasuar.

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket rrugëve ne e dimë që reshje të borës nuk ka pasur po ka pasur punë të tjera dhe rrugët janë mirëmbajtur dhe kanë bërë pastrime të ndryshme. Është bërë krasitja e drunjve dekorativ.

Refet Kalisi thekson:- jam për me i ndihmuar kompanisë dhe punët të cilat kryhen ne të paguhen. Punët të cilat i vlerëson komisioni që janë kryer është mirë që edhe na me i ditur në kuvend.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI FINACIARË PËR PERIUDHËN JANAR –MARS 2023

3. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- rregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat dhe është përcjell për kuvend për miratim.

Zaim Bela thekson:- a keni marr ndonjë vendim për çështjen e mbeturinave të ngurta.

Arsim Dernjani thekson:- për mbeturinat e ngurta jemi duke u munduar me gjet një parcelë për shkak se kompania “Sharrcem” nuk pranon mi hedh atje.

Refet Kalisi thekson:- unë jam që të bëhet ngritja e çmimit por propozoj që ekonomitë familjare të cilët e kryejnë pagesën për tërë vitin është mirë me i subvencionuar sepse e keni cekur vetëm 10 % dhe propozoj që të jetë 20 % .

Sevdi Dernjani thekson:- ekzekutivi i komunës nuk e vendosë çmimin për kompaninë Pastrimi sa duhet të jetë por mund të vjen një propozim prej kompanisë pastrimi në kuvend dhe pastaj kuvendi vendosë për atë çështje . Ekzekutivi i komunës e ka kontraktuar kompaninë pastrimi për mirëmbajtjen e rrugëve.

Sherif Berisha thekson:- si Lëvizje Vetë Vendosi jemi kundër kësaj ngritje të çmimit dhe kemi kërkuar që të shqyrtohet vendimi që është marr në asamblë komunale që punëtorëve të kompanisë Pastrimi me ju ngrit paga për shkak se në miratimin e buxhetit që është bërë kësaj kompanie i kemi ndarë mjete financiar mbi pesëdhjetë mijë euro. Ne kemi kërkuar që të ketë auditim por deri më tani nuk ka ndodhë një gjë e tillë. Për deponit e ngurta duhet të bëhet zgjidhje për shkak se qytetarët nuk dinë ku me dërguar materialin e ngurtë.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj se ngritja e çmimeve është paraparë edhe për ngritjen e pagave të punëtorëve. Për materialet e ngurta ekzekutivi e ka realizuar marrëveshjen me kompaninë “Sharrcem” te vendi i quajtur Llapor dhe ndër kohë e kanë ndaluar . Është një shqetësim si komunë dhe si qytetarë sepse është koha që qytetarët punojnë por do të mundohemi që përmes bordit lokal të Sharrcemit që brenda mundësive të na jë lejojë hedhjen e mbeturinave. Është mirë me ju përmbajtur rregullave që i ka kompania “Sharrcem” .

Resul Suma thekson:- më pëlqen plani afat gjatë që e kanë për klasifikim dhe riciklim të mbeturinave por për shkak që nuk ka raport financiarë dhe një analizë financiare se ku do të shkojnë mjetet financiare të cilat do të grumbullohen nga ngritja e çmimeve nuk do ta votojë.

Sevdi Dernjani thekson:- çështja e auditimit duhet të iniciohet përmes komisionit të aksionarëve direkt te bordi i kompanisë pastaj bordi te kryeshefi ekzekutiv i kompanisë. Komuna ka kontratë me kompaninë Pastrimi që i kërkon shërbime dhe kontratën mundëni me pas se çka përmban.

Sherif Berisha thekson:- në këtë drejtim nuk ka arritur mirëkuptim për atë e kam paraqitur në kuvend

Sevdi Dernjani thekson:- është rregullorja e cila i paraqet kompetencat e komisionit të aksionarëve dhe si asamblistë mund të ngritni çdo çështje në kuvend.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka propozimin prej 6.50 € e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, propozimin nga debati publik që është dhënë për ekonomitë familjare të jetë taksa 7 € e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri kundër. Në tërësi e hedh në votim rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Hanit të Elezit; rezultati i votimit ishte 13 për, 1 kundër , 1 abstenim.

U MIRATUA RREGULLORJA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

4. Kërkesa e znj.Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- znj.Hanushe Dernjani ka parashtruar kërkesë për ndërrim destinim të pronës për ndërtimin e një ferme për rritjen e viçave për majmëri.

Zaim Bela thekson:-jemi pro që të japim pëlqimin për ndërrim destinim të pronës edhe pse këto kanë përfutur një grand prej Ministrisë së Bujqësisë dhe nëse ka kërkesa tjera duhet t'i miratojmë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E ZNJ HANUSHE DERNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

5. Informatë për ndarjen e bursave.

Hisni Luri thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- ankesë kam prej një qytetari që vajzë së tij ju ka refuzuar bursa edhe pse ka qenë në fakultet të arkitekturës . Kërkoj që të më sjellët lista e studentëve të cilët nuk kanë përfutur bursë. Nëse keni informata për studentët të cilët janë përfutues nga Republika e Maqedonisë na njoftoni.

Hisni Luri thekson:- përfutues i bursës është vetëm një studentë që është në vitin e parë dhe ka qenë kuadër deficitare. Listën e studentëve të cilët nuk kanë qenë përfutues të bursës mund tu a sjelli.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson:-nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- sa ekonomi familjare janë pa kontrata të cilave shërbimet ju bëhen prej kompanisë. Sa borxh i kanë ekonomitë familjare kompanisë

Sevime Bajrami thekson:-borxhi është i paraqitur në raport dhe gjithsejtë borxh i kanë në shumë prej 33 000 €

Sherif Berisha thekson:- cilat lloje të bizneseve janë të obliguar të lidhin marrëveshje me kompaninë. Kompanitë taksi a janë të obliguar me lidhur marrëveshje.

Sevime Bajrami thekson:-gjitha llojet e bizneseve që operojnë në komunën e Hanit të Elezit janë të obliguar me lidh kontratë . Kompanitë taksi nëse e kanë ndonjë zyre janë të obliguar me lidhur marrëveshje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Raporti i komisionit komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- sqarimin e paraqita në fillim dhe diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- është mirë që të njoftohen edhe fermerët e tjerë të cilët merren me këtë lloj të veprimtarisë të njoftohen me procedurat.

Zaim Bela thekson:- dëmi që është shkaktuar a është i vitit 2022 apo i vitit 2023 dhe sa e ka vlerësuar komisioni dëmin.

Abduraman Bushi thekson:- dëmi është shkaktuar në vitin 2023 dhe raportin e komisionit e keni para vetës dhe si të votohet raporti do ta përcjellim për pagesë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI KOMUNAL PËRFUNDIMTARË PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

8. Propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Ditët e Kulturës dhe Festivalin Mbarëkombëtarë” 2023 në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- ideja është që ta zyrtarizojmë së bashku me juve në kuvend këtë festival folklorik mbarë kombëtarë . Materiali është dërguar me vonesë por për shkak të përmirësimeve nga gjendja e kaluar. Për çështjen e festivalit kemi angazhuar persona profesional dhe do të mundohemi në bazë të buxhetit të cilin e kemi për me realizuar. E kemi paraqitur si ditët e kulturës për shkak se java kulturore është vetëm shtatë ditë ndërsa dhe e kemi paraqitur në këtë forum se aktivitetet do të kemi deri në muajin gushtë duke i përfshirë edhe mërgimtarët. Për të gjitha aktivitetet do t'i sjellim në kuvend edhe shpenzimet që do të bëhen për ditët e kulturës. Çmimet nuk i kemi paraqitur për shkak se janë ndryshuar për shkak të inflacionit .

Zaim Bela thekson:-ditët kulturore janë tradicionale por festivalin nuk e kishim lënë tradicional për shkak se ka një kosto të lartë për shkak se e kemi pas lënë panairin dhe pastaj u krijuan telashe sepse duhen mjete financiare për me realizuar.

Sherif Berisha thekson:- për çështje të zërimit është planifikuar shuma 1000 €, ndërsa për sallën e kulturës që është realizuar projekti vlera e zërimit ka qenë 20 000 € dhe pjesa e zërimit që është aty nuk kushton as 1000 € dhe nga ekzekutivi është bërë pranimi teknik për këtë çështje. Mikseta e zërimit që është vendosur nuk e ka vlerën më shumë se njëqind euro dhe kush do që e ka bërë pranimin teknik ka gabuar dhe ne të shkon në përgjegjësi.

Malik Berisha thekson:- janë disa gara dhe të gjitha planifikohen në shkollën fillore me u mbajtur kur e dimë që sall sportive ka edhe fshati Paldenicë dhe fshati Gorancë dhe kemi mundësi me i nderuar.

Kryesuesi thekson:- këtu kërkohen 18,500 € ndërsa këtu janë arsyetuar 12,250 € dhe pjesën tjetër kisha dashur me arsyetuar drejtori dhe në mbledhjet e ardhshme me ma njoftuar për të gjitha shpenzimet që janë bërë . Janë cekur edhe personat të cilët mbajnë rend që do të paguhet dhe për aktivitet e tjera a do të paguhet. Janë paraparë shtatë persona organizatorë a dihen emrat e tyre. Për grupet të cilat vijnë nga lartë a është paraparë çështja e fjetjes.

Hisni Luri thekson:- është e vërtet se ndoshta mund të kemi probleme me mjete financiare nëse mbetet festivali tradicional por ja vlen. Sa i përket pranimi teknik nuk kam marr pjesë por ka telashe nga pak po ashtu kemi telashe edhe në funksionalizimin sepse kemi probleme me staf. Propozimi për festivalin është bërë prej personave profesional të cilat i kanë bërë planifikimet, të cilët i kanë bërë planifikimet për akomodim, ndërsa juria është e përcaktuar prej tre personave të cilët janë profesional, ndërsa të tjerët do të jenë prej shoqërisë kulturore artistike dhe prej stafit komunal. Çështjen e sallave e kemi diskutuar por vitin e kaluar kemi pasur telashe për me i bartur nxënësit. Garat shkollore do të bëhen nëpër shkolla ndërsa gara në mundje do të realizohet në qendër.

Refet Kalisi thekson:- festivali është duke u realizuar për herë të parë dhe do ta përkrahë drejtorin dhe besoj që është në favor të Hanit të Elezit.

Hyriete Isufi thekson:- drejtorin e përgëzoj së pari për guximin sepse është një punë bukur e madhe dhe shpresoj do të ketë suksese, ndërsa sa i përket shpenzimeve në fund mundeni me na njoftuar.

Nexhmedin Daci thekson:- zërimi është qendrorë në shtëpinë e kulturës por ky është zërim që bëhet për festivale. Zërimi e ka vlerën ashtu siç e ka pasur në paramasë që është bërë në projekt dhe më detalisht mund të njoftoj në mbledhje të radhës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDRJEN E MJETEVE FINACIARE PËR DITËT E KULTURËS DHE FESTIVALIN MBARË KOMBËTAR

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- deri tash dëgjova diskutime të ndryshme po ashtu edhe z.Sherif Berisha por është mirë që të shkon në qeveri dhe të bënë një apel që qeveri ta rregullon rrugën në fshatin Gprancë sepse komuna i ka dhënë kontributet e veta edhe pse rruga është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës. U diskutua çështja e festivalit se a do të mundemi me organizuar apo jo por me organizuar një festival në komunën e Hanit të Elezit nuk është diçka e keqe por është mirë për shkak se edhe qytetet e tjera informohen me Hanin e Elezit. Ankesa ka për materialet e ngurta për shkak se i prishin shtëpitë dhe nuk kanë ku me i hedhur. Është mirë që drejtoria për bujqësi së bashku me Labin me dhënë subvencione në vendet të cilat ja vlejnë. Është mirë që të bëhet edhe një rrugë për në fshatin Paldenicë për shkak se me kompaninë “Bektelenka” është lejuar ajo pjesë nëse bëhen rrënimet dhe është mirë që me bërë atë rrugë për fshatin Paldenicë.

Sherif Berisha thekson:-kërkesa ime ka qenë mos me u protestuar në rrugë por para komunës dhe mandej me dal në atë vend dhe me bllokuar rrugën pavarësisht kush është në qeveri por qytetarët të kesin rrugë dhe të ju realizohen qëllimet.

Resul Suma thekson:- nuk e di drejtori i shërbimeve publike se a ka informacione sepse Hani i Elezit nuk ka ujë që tri ditë dhe edhe sa kohë do të lëshohet ajo fabrikë . Po flitet se rruga Gorancë –Globoqicë është e mbyllur deri ku kanë mbërri punët sepse e di që qeveria mund të jep premtime boshe. Ariu në fshatin Krivenik i ka bërë dëm një fermeri dhe ja ka shkatërruar njëzet e një shoqëri të bletëve dhe sipas nenit pesëdhjetë e katër të ligjit për gjueti komuna apo Ministria e Bujqësisë janë të obliguar t i paguajnë dëmet e shkaktuara nga shtazët e egra dhe komuna është mirë me i ndihmuar në përgatitje të dokumentacionit që dëmin me ja paguar Ministria e Bujqësisë.

Arsim Dernjani thekson:- problemi me çështjen e ujit është që dy ditë për shkak të problemeve që i kemi pasur por e kemi rregulluar. Çështja e ujit ju e dini që është projekt i gjerë dhe punët që i kanë takuar komunës i kemi bërë gati por problemi është te pranimi teknik të cilin është dashur me bërë CDI-ja dhe po presim që të bëhet pranimi teknik.

Sevdi Dernjani thekson:-për çështjen e rrugës së Gorancës vazhdimisht kemi bërë kërkesa të vazhdueshme në Ministrinë përkatëse, ndërsa arsyetimi i zëvendës ministrit të Infrastrukturës është që çmimet e kontratës që janë me kompaninë kontraktuese janë rritur për 20% dhe deri në muajin qershor i kanë dhënë afat kompanisë me i kryer punimet . Rruga Hani i Elezit-Gorancë është rrugë regjionale dhe është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës

Abduraman Bushi thekson:- dëmet të cilat shkaktohen nga kafshët e egra në bujqësi është obligim i Ministrisë dhe obligim i drejtorisë është vetëm përgatitja e raportit të dëmeve të cilin ja kemi bërë fermerit dhe ka vazhduar me procedura të më tutjeshme.

Kryesuesi thekson:-AMF-ja në fshatin Gorancë a është në funksion . Kërkoj informacion edhe për çështjen e drejtoreshës në QKMF.

Malik Berisha thekson:- a është lidhur kontrata me Karitasin apo kur pritet me ardhur.

Hanumshahe Dibrani thekson:- janë disa drita të ndriçimit publike që nuk janë funksionale.

Refet Kalisi thekson:- te projektet është paraparë një aneks në shumë prej 25,000 € ku është paraprë me u ndërtuar .

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- AMF-ja në fshatin Gorancë është funksionale sipas orarit të cilin e kemi paraqitur por për muajin Ramazan orari ka qenë prej orës dhjetëve deri në ora dymbëdhjetë për shkak se pacientët më herët nuk kanë shkuar . Me përjashtim kur ka trajnime dhe ftesa të veçanta në Ministri dhe në pa mundësi me zëvendësuar me staf i njoftojmë qytetarët me kohë . Sa i përket Karitasit procedurat janë duke u zhvilluar me prokurim. Për shkak të rekomandimeve të cilat i kemi pasur prej inspektoratit farmaceutik për barnat me afat skaduar të cilat nuk guxon të jenë jashtë objektit të QKMF-së është parë e nevojshme që ta kemi një depo afër QKMF-së . Drejtoresha ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit dhe si mjeke por ne kemi bërë njoftimin sipas procedurave edhe për mjek edhe për pozitën e drejtorit.

Arsim Dernjani thekson:-për çështje të ndriçimit e kemi kontratë dhe është mirë të na njoftoi saktë për dritat të cilat janë prishur.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:31.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

REPublika e Kosovës
 Republika Kosovo
 Republic of Kosovo
 Komuna - Opština - Municipality
 Hani i Elezit

Nr. i Prot. 05/3761
 Nr. i Faq. _____ Data: 05.05.2023



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
 Komuna - Municipality
 Hani i Elezit



DATA:	05.05.2023
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës
KOPJE:	Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit z. Mehmet Ballazhi
NGA:	Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme znjsh. Natyra Kalisi
LËNDA:	Shkresë Përcjellëse: draft Strategji për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunes së Hanit të Elezit



Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese, të bashkangjitur gjeni draft Strategjinë për e Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.



Komuna e Hani i Elezit

STRATEGJIA KOMUNALE PËR INFORMIM, KOMUNIKIM DHE PJESËMARRJE QYTETARE

2023 – 2026

Hani i Elezit 2023

I. HYRJJE

Komuna e Hani i Elezit në vazhdimësi është përpjekur që t'i përmirësojë dhe avancojë mekanizmat e vet të komunikimit me audiencat e shumta me synimin që t'u përgjigjet dinamikave të reja teknike dhe teknologjike dhe nevojave e kërkesave të qytetarëve për shërbime cilësore dhe informim të saktë e të kohshëm.

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie për informim dhe komunikim është që të mbështesë traditën tashmë të krijuar të komunikimeve të strukturuar në mënyrë që mekanizmat komunikues të jenë efikas, të përshtatshëm e të qëndrueshëm dhe si të tillë të mbështesin përmbushjen e misionit të komunës *për një shoqëri të hapur që promovon diversitet dhe shkëmbim ide e mendimesh, duke i*

Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfutur nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit. Përmes këtij Strategjie do të kërkohet një reagim pro-aktiv i audiencave ndaj punës, aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, medie, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026 është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me akterë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Një strategji efikase e informimit dhe marrëdhënieve me publikun mbështetet fort në kontributin dhe rolin aktiv të të gjithë të punësuarve në administratën dhe institucionet komunale. Për këtë arsye, pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që ekskluzivisht përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të zyrtarëve për informim, kurse në raste të veçuara do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

2. SFONDI

2.1. Profili i komunës

5. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Rinisë dhe Sportit,
6. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,
7. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: Zyra për komunikim dhe informim, , Zyra Ligjore, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Prokurimit, Zyra për Integritet Evropian dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim.

Misioni i Komunës:

Misioni i komunës është që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, infrastrukturë dhe teknologji moderne, mundësi të njëjtë të edukimit për të gjithë, fuqi të kualifikuar punëtore. Një vend që respekton ambientin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të vet dhe të fqinjëve, me një shoqëri të hapur që promovon diversitetin dhe shkëmbim idesh, mendimesh, duke i respektuar mendimet e të tjerëve.

2.3. Korniza Ligjore

Hartimi i kësaj Strategji është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Hani i Elezit 01.7703 –përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

3. GJENDJA AKTUALE ME INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN

Komuna e Hani i Elezit ka përvoja të vlefshme në aspektin e komunikimeve strategjike nga e kaluara. Në vitin 2015, Komuna hartoi *Strategjinë për Informim dhe Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015 – 2018*, përmes të cilës vuri themelet për një komunikim të strukturuar me audienca të ndryshme. Në përgjithësi, kjo strategji trevjeçare kishte për synim që të përmirësonte komunikimin dhe ndërveprimin me publikun, të krijonte një mekanizëm të qëndrueshëm të komunikimeve të brendshme, të rriste transparencën e veprimtarisë së komunës, të nxiste pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, të shtonte praninë në mediat lokale dhe qendrore, por edhe të vendoste një bashkëpunim sistematik me partnerët dhe donatorët e komunës.

Së këndejmi, viteve të fundit, Komuna e Hani i Elezit ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të diversifikojë kanalet e komunikimit me audiencat të ndryshme me synimin që të sigurojë një informimin sa më gjithëpërfshirës, nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe një ndërveprim të intensiv me mediat dhe publikun, hisedarët, partnerët dhe donatorët e komunës.

Ky komunikim përgjithësisht është realizuar përmes formave të ndryshme për komunikim me qytetarë, takimeve të strukturuar me publikun, konferencave për shtyp, komunikatave për media, paraqitjeve publike në media, intervistave, tabelave të shpalljeve, kontakteve dhe vizitave të drejtpërdrejta me qytetarë, takimeve me Këshillat e Fshatrave, takimeve në organizatat e shoqërisë civile, kontakteve afaristë, investitorë dhe donatorë, si vendorë ashtu edhe të jashtëm.

3.1. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale ka avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka mbështetur komunikimin e jashtëm, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikat në rritje të qeverisjes lokale. Pavarësisht nga kjo, ka hapësira për ndërhyrje në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes kësaj Strategjie është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (*komunikim nga lart-poshtë*), shkëmbime ndër-sektoriale (*komunikim i tërthortë*) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (*nga poshtë-lart*).

3.2. Informimi

Synim primar i komunës mbetet informimi i qytetarëve mbi punën e organeve të saj. Angazhimi i kryetarit të komunës, i kuvendit të komunës, i drejtorive dhe segmenteve tjera të komunës në vazhdimësi synohet që t'i prezantohet qytetarëve përmes informimit të shpejtë dhe të saktë. Publikimi me kohë i vendimeve të kryetarit të komunës, i vendimeve të kuvendit të komunës, i raporteve të punës së drejtorive të komunës me theks të veçantë i raporteve periodike financiare

Komuna mban edhe takime me qytetarë në forme të debateve publike, si dhe bashkëpunon me qytetarët si partner për realizimin e projekteve me interes të përgjithshëm. Në këtë drejtim, fokusi i Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë natyrës specifike të platformave për komunikim social.

3.5. Marrëdhëniet me mediat

Në territorin e komunës së Hani i Elezitt operojnë një numër i madh i mediave, qoftë tradicionale apo atyre të reja, të cilat të gjitha bashkë përbëjnë një potencial të rëndësishëm për intensifikimin e informimit publik dhe komunikimit me audiencat.

Një e dhënë tjetër pozitive është ekzistenca e një numri të konsiderueshëm të mediumeve online (portaleve), të cilat përveçse janë shumë aktive, kanë edhe një numër të konsiderueshëm ndjekësish. Mediumet online, po ashtu, përbëjnë kanale të rëndësishme për transmetimin e njoftimeve, informacioneve, shpalljeve dhe ngjarjeve a veprimtarive të ndryshme që organizohen nga komuna dhe për komunën.

Gjatë viteve në vijim, komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuara mbi praktikën tashmë të etabluar të komunikimit, profesionalizmin e stafit në Zyrën për Komunikim për Informim si dhe marrëdhënie e shëndosha me mediat të ndërtuara. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformat e komunikimit social, produksionit vizual dhe transmetimeve nga vendi i ngjarjes (livestreaming).

4. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM

Komuna e Hani i Elezit e ka për obligim që publikut t'i ofrojë informacione mbi prioritetet, politikat, programet, projektet, strategjitë, shërbimet dhe vendimet e saj. Platforma e komunës për informim dhe komunikim do të mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohëshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Kjo platformë mbështetet në elementet e mëposhtme:

Transparenca – Me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë kontekst është transparenca e ushtruar me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

Llogaridhënia – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në parimin e llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës, sidomos në çështjet që ndërlidhen me buxhetin, financat dhe shpenzimet e komunës.

Përgjegjshmëria – Komunikim i rregullt i autoriteteve komunale me qytetarët që siguron shkallë të lartë të përgjegjshmërisë së udhëheqësve përballë premtimeve, sukseseve dhe dështimeve eventuale të komunës.

Gjithë përfshirja – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit.

Mos diskriminimi – nënkupton informim të drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Parimi i mos diskriminimit në të njëjtën kohë nënkupton edhe marrjen parasysh dhe adresimin nga ana e komunës së kërkesave të të gjithëve pa asnjë dallim.

Shumëllojshmëria – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

Informimi me kohë – nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të kohshëm në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

Informata kthyesë – nënkupton ofrimin i mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të përmirësimit të performancës së saj.

3. Rritja e cilësisë së informimit, transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë

Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të instalojë një qasje komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë këtë, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje (përmes zbatimit të plotë të Planit të Transparencës 2023-2026); të ndërtojë marrëdhënie të mira me qytetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e mbështetësit tonë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

6. KANALET E KOMUNIKIMIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e mediave të reja dhe kërkesat e kësaj strategjie, Komuna e Hani i Elezit do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat e jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar të publiku. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Emaili - Në një institucion zyrtar, emaili është një kanal i pazëvendësueshëm komunikimi edhe për faktin se përmbajtjet e mesazheve të emailit kanë pothuajse një status të komunikimit zyrtar. Duke pasur parasysh këtë fakt, është shumë me rëndësi që të punësuarit administratën komunale t'i avancojnë njohuritë për përdorimin e duhur dhe efikas të llogarive zyrtare, përtej normave të përcaktuara me rregullore dhe udhëzime administrative. Për këtë arsye, që në vitin e parë të kësaj Strategjie, Komuna do të shpërndajë *Udhëzuesin për përdorimin e duhur dhe efikas të komunikimit me email*.

Intraneti qeveritar - Është një platformë e mirë për vendosjen e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve relevante në një vend të vetëm, mundëson një qarkullim të lirë të informacionit dhe përbën një medium ku të punësuarit mund të shprehin idetë dhe mendimet e tyre. Për më tepër, intraneti është një kanal që mundëson qasje të lehtë dhe të shpejtë në informacionet zyrtare për të gjithë të punësuarit në administratën komunale.

Aplikacionet qeveritare - janë një mundësi e mirë për komunikim dhe koordinim të brendshëm dhe ndërinstitutional sepse ofrojnë mundësojnë komunikimin përmes pajisjeve që sot secili i punësuar i ka në dispozicion. Aplikacionet mundësojnë një komunikim të atypëratyshëm në secilën periudhë të ditës dhe në pavarësi të plotë nga lokacioni apo pasja e një kompjuteri. Në të ardhmen Komuna do të përpiqet që të shtojë përdorimin e aplikacioneve zyrtare të licencuara dhe që plotësojnë standardet e sigurisë dhe cilësisë dhe që janë në pronësi të Qeverisë, si për shembull *Skype for Business* dhe *Microsoft Teams*. (Këto aplikacione mund të përdoren pa kosto shtesë në kuadër të domenit qeveritar).

Tabelat e informimit – Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit digjitale për qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë te qytetarët të jenë të dukshme dhe të disponueshme për sa më shumë të interesuar.

7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Hani i Elezit kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e duhura te audiencat e duhura dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit. Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

8. INTERVENIMET NË MEKANIZMAT E KOMUNIKIMIT

Në funksion të realizimit të objektivave të kësaj Strategjie, Komuna e Hani i Elezit në tre vitet pasuese do të kryejë disa ndërhyrje, të cilat janë të dizajnuara të përmirësojnë mekanizmat e komunikimeve në tërësinë e vet.

Për më tepër, Komuna do të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet akademike (universitetet) me qëllim të përfitimit reciprok në ngritjen e cilësisë dhe performancës në punë. Këto intervenime dhe aktivitetet të tjera, në trajtë të strukturuar do të paraqiten në planet vjetore të kësaj strategjie.

Praktikat e komunikimit të brendshëm në administratën komunale (Objektivi I)

- Hartimi i Udhëzuesit për Komunikim me llogaritë zyrtare të emailit.
- Azhurnimi i programit të trajnimeve në funksion të ngritjes teknike dhe profesionale të të punësuarve në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Zëvendësimi i pajisjeve/mjeteve teknologjike të vjetruara apo të dala jashtë funksionit.
- Zbatimi i procedurave standarde për plasimin e informatave në ëbsajtin e komunës në përputhje me doracakun për publikimin e akteve dhe politikave publike në nivel komunal.
- Përdorim i shtuar i intranetit qeveritar dhe aplikacioneve qeveritare për komunikim në distancë dhe punët ekipore (*Skype for Business, Microsoft Teams*)
- Mbledhje të rregullta të udhëheqësve të sektorëve me personelin që kanë në mbikëqyrje.
- Takimet e përgjithshme me stafin e administratës komunale (së paku dy herë në vit) për të diskutuar çështje që ndërlidhen me dhe për objektivat dhe planet e qeverisë komunale

- Vendosja e monitorëve nëpër zona urbane dhe rurale për në funksion të informimit, komunikimit dhe promovimit të aktiviteteve të komunës.
- Përgatitja dhe transmetimi i buletini televiziv mujor mbi ngjarjet më të rëndësishme në komunë përmes marrëveshjeve kontraktuale me televizionet lokale.
- Organizimi i konferencave për shtyp për prezantimin e raporteve periodike të Kryetarit të Komunës.
- Publikimi i broshurës elektronike për të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet publike dhe shpërndarja përmes kanaleve në dispozicion të komunës.

9. BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2022

OBJEKTIVI	KOSTOJA (€)
(1) Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale	0
(2) Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe ndërveprimit me qytetarë	1500
(3) Promovimi i komunës, aktiviteteve dhe aseteve komunale	2500
GJITHSEJTË	3500

10. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	
Kryetari i Komunës	Nxit, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme. Mbështetë zbatimin efikas të kësaj Strategjie.
Drejtorët e drejtorive komunale	Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj. Furnizojnë ZIKP me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut.

REPublika e Kosovës
REPublika KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA / MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT
Nr. i Prot. 03/3762
Nr. i Faq. Data 05.05.2023



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



DATA:	05.05.2023
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës
KOPJE:	Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit z. Mehmet Ballazhi
NGA:	Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme znjsh. Natyra Kalisi
LËNDA:	Shkresë Përcjellëse: draft Plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i Komunës së Hanit të Elezit



Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese, të bashkangjitur gjeni draft Planin e Veprimit për Transparencë 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E HANIT TË ELEZIT • MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT



Plani i Veprimit për Transparencë – Komuna Hani i Elezit

2023-2026

Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi .

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësisë dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në faza të caktuara të procesit të avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërfaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirëorganizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i Veprimit për Transparencë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave bazuar në këtë rregullativë juridike, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjate.

- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave;
- Mbajtjen e një sistemi koherent me të gjitha palët e interesit për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e Komunës. Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e Kryetarit, njoftimet për aktivitetet e Kuvendit Komunal, takimet publike, transparencës buxhetore, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit publik, qasjen në dokumentet publike, etj.

Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është

- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

- Statuti i komunës;
- Rregullore komunale për transparencë;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim, 2016-2021;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të Mire 2017-2021;
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021;
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument specifik me ndikim në transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*. Bazuar në problemet e identifikuara, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;
- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.¹

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës: “Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026”, Prishtinë, 2016, fq. 32

Mekanizmat ligjor për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunitet janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mbledhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunitet ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politikbërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projekte dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, peticionet dhe referendumat lokale;

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikat e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkakë juridike, por edhe praktike.

- 4) *Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë* - përfshin monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të Veprimit për Transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioriteteve, duke mundësuar që Komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: 1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtrirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e planit të veprimit, të cilat janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

Monitorimit i zbatimit të Planit të transparencës

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politikbërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit e matjes	Afati kohor	Njësia/personi përgjegjës	Mënyra e njoftimit / zbatimit	Dokumentet referuese	Forma	Kolonë raportimi
Transparenca e kuvendeve të komunave								
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet e Kuvendit të komunës	Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për përcësuesit publikë dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara/elektronike në takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve	1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës ; 2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të komiteteve në ueb faqe zyrtare të komunës	1) Njoftimi sipas (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta të Kuvendit; 2) Njoftimi sipas (3) ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme; 3) Thirrja brenda ditës për mbledhje urgjente	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	Përmes ueb-faqes zyrtare; Shpalljeve publike; Formave të tjera të informimit.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; - Statuti i Komunës; - Rregullorja komunale për transparencë	Të aplikuara në formatet .doc .pdf	
	Transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës	Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejtpërdrejt	Në vazhdimësi	Sekretaria e Kuvendit; Zyrtari i IT-së; Zyra e informimit;	Përmes ueb-faqes zyrtare; Transmetim nga vet KK Hani të Elezit sipas modelit të Kuvendit të Kosovës; Rrjetet sociale; Youtube;	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; - Statuti i Komunës		
	Publikimi i akteve të kuvendit të komunës	1) Numri i akteve të aprovuara;	Pas afatit 15 ditë të shqyrtimit të ligjshmërisë	Kryesuesi i Kuvendit; Zyra për informim	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Rregullorja (MAPL) Nr. 01/2017 për	Të aplikuara në formatet	

	Ofrimi i shërbimeve elektronike nga Qendra	Informimi dhe ofrimi i shërbimeve të hapura online nga Qendra. Ofrimi i shërbimeve për qytetarët përmes E-kioskës.	Në vazhdimësi	Drejtori i Administratës / Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Qendra për shërbim të qytetarëve	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 03/2018 për funksionimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në komunë		
--	--	---	---------------	---	----------------------------------	--	--	--

		për Platformën e Qeverisë për konsultime publike.					Konsultimit Publik në Komuna;		
	Mbledhja/shqyrtimi i komenteve/propozimeve gjatë procesit të konsultimit publik dhe përgatitja raportit për rezultatet e konsultimit publik	1. Numri i komenteve të parashtruara; 2) Raporti për rezultatet e konsultimit publik i hartuar dhe publikuar.	Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendari për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim	Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt propozimit në bashkëpunim me grupin punues dhe zyrtarin përgjegjës për konsultime publike	Publikimi në ueb-faqe i formularit standard për konsultimet publike i; Komentet e pranuar përmes zyrtarit përgjegjës; Publikimi i dokumentacionit për konsultim në ueb-faqen e komunës dhe platformën qeveritare të konsultimeve publike.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;			
Garantimi i plotë i të drejtave për qasje në dokumentet publike	Shqyrtimi i rregullt i kërkesave për qasje në dokumente publike	1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët; 2) Numri i kërkesave të shqyrtuara për të cilat palët kanë marrë përgjigje	(7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi	Zyra për informim / Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtarë; Qendra për Shërbim të qytetarëve Njësia përgjegjëse për ofrimin e qasjes	Pranimi përmes zyrtarit përgjegjës për konsultime publike. Shqyrtimi nga organi kompetent;	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike			

	Publikimi i KAB-it	KAB i publikuar në ueb-faqen e komunës	pas miratimit në Kuvendin Komunal	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit	Ueb-faqja e komunës			
	Mbajtja e konsultimeve me qytetarë për projektbuxhetin e Komunës	Konsultimet publike për projektbuxhet, të mbajtura	Para datës 1 shtator	Kryetari i komunës/ Drejtoritë	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim; Konsultimet elektronike; Publikimi në Platformën qeveritare për konsultime publike; Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		
Publikimi i buxhetit vjetor		Plani buxhetor i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	Të aplikohen formatet .xlsx .pdf	
Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së kryetarit/ekzekutivt	Diskutimi i raportit të kryetarit në kuvendin e komunës	Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës	Njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga	Kryetari i komunës; Ekzekutivi;	Përfshirja në rend dite; Diskutimi në kuvend	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;		

Mbajtja e se paku dy takimeve publike me qytetarë brenda vitit	2 takime të mbajtura gjatë vitit	Takimi i parë në gjashtëmujo rin e parë të vitit; Takimi i dytë në gjashtëmujo rin e dytë të vitit	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit;	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	Të aplikohe në formatet .doc .pdf	
Numri i takimeve konsultative tjera në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera.	Numri i takimeve për të cilat është plotësuar kushti i njoftimit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare; Numri i takimeve për të cilat kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku janë evidentuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, brenda 15 ditëve pas përfundimit të takimit.	Njoftimi i shpallur 14 ditë para takimit në gjuhët zyrtare	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit;	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	Të aplikohe në formatet .doc .pdf	
Shqyrtimi i kërkesave/iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve	1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari; 2) Numri i iniciativave kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të shqyrtuara brenda 60 ditësh; 3) Numri i njoftimeve të publikut brenda 15 ditësh për kërkesat,	Në vazhdimësi	Kryetari i komunës; Kuvendi i komunës		Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;		



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



DATA	22.05.2023
PËR	Kuvendin e Komunes së Hanit të Elezit
PËRMES	Kryetarit të Komunës z. Mehmet Ballazhi <i>M Ballazhi</i>
NGA	Majlinda Kaloshi – Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik Hisni Luri – Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport <i>Hisni Luri</i>
LËNDA	Ndryshimet dhe Plotësimet në Statutin e Komunës së Hanit të Elezit

Të nderuar,

Së bashku me këtë shkresë po ju përcjellim propozimet për ndryshime dhe plotësime të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, përkatësisht ndryshimet në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe në Drejtorinë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Sipas procedurave, materiali i është nënshtruar debatit publik për qytetar nga ku kanë dalë edhe propozime të reja të cilat janë shqyrtuar nga grupi punues!

Me respekt!

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Përgjegjësitë aktuale:

- a) Koordinimi i aktiviteteve dhe veprimeve për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e PZHK apo strategjive të tjera në nivel komunal
- b) Koordinimi dhe bashkërendimi për harmonizimin e strategjive të Komunës me strategjitë rajonale dhe kombëtare
- c) Hartimin e projekt politikave në ndihmë të zhvillimit ekonomik të komunës dhe biznesit
- d) Koordinimi në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për PZHK dhe strategjive në nivel komune
- e) Inkurajim dhe promovim i zgjerimit të bizneseve dhe sipërmarrjes në komunë kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- f) Ofrim dhe nxitje të përmirësimit të shërbimeve të komunës ndaj biznesit
- g) Inkurajim, mbështetje dhe menaxhim i programeve e projekteve në mbështetje të biznesit
- h) Hulumtime për qështjet e zhvillimit ekonomik dhe të biznesit në komunë
- i) Mundësim i marketingut dhe promovimit të komunës dhe potencialeve të saja
- j) Mirëmbajtje e statistikave të aktiviteteve biznesore në nivel komune
- k) Harton plane për zhvillimin e industrisë zëjtare, dhënien e pëlqimit teknik të lokaleve, inkasimin e pagesave të veprimtarive afariste etj.
- l) Harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda komunës
- m) Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Propozimet

Emërtimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

- a) Përgjegjëse për hartimin e Strategjive zhvillimore ekonomike.
- b) Koordinimi dhe bashkërendimi për harmonizimin e strategjive të Komunës me strategjitë rajonale dhe kombëtare.
- c) Hartimin e projekt politikave në ndihmë të zhvillimit ekonomik të komunës dhe biznesit.
- d) Inkurajim dhe promovim i zgjerimit të bizneseve dhe sipërmarrjes në komunë kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- e) Ofrim dhe nxitje të përmirësimit të shërbimeve të komunës ndaj biznesit.
- f) Inkurajim, mbështetje dhe menaxhim i programeve e projekteve në mbështetje të biznesit.
- g) Hulumtime për qështjet e zhvillimit ekonomik dhe të biznesit në komunë.
- h) Mundësim i marketingut dhe promovimit të komunës dhe potencialeve të saja.
- i) Mirëmbajtje e statistikave të aktiviteteve biznesore në nivel komune.
- j) Harton plane për zhvillimin e industrisë zëjtare, dhënien e pëlqimit teknik të lokaleve, inkasimin e pagesave të veprimtarive afariste etj.
- k) Harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda komunës.
- l) Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

- m) Përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e planeve strategjike me fokus turizmin.
- n) Krijon kushte për zhvillim të projekteve me qëllim të tërheqjes së investimeve në pikat turistike të territorit të komunës.
- o) Përgjegjëse për promovimin e vendit përmes materialeve informuese për Hanin e Elezit
- p) Organizon takime informuese, konferenca dhe punëtori me qëllim të zhvillimit të bizneseve dhe evente të tjera që i përkasin sektorit të turizmit.
- q) Udhëheq mënyren e aplikimit në projektet inovative të organizatave të huaja dhe vendore me qëllim të zhvillimeve të reja në vend.

Propozimet:

Të ndahet drejtoria e Arsimit dhe të themelohet një drejtori e re për Kulturë, Rini dhe Sport

Këto janë punët dhe përgjegjësitë që duhet ti kalojnë si drejtori dhe të ndahen nga drejtoria aktuale që është edhe drejtoria për arsim.

Menaxhon në mënyrë të drejtë me të gjitha objektet e komunës, të kulturës, sportit dhe rinisë.

Organizon takimet me rëndësi kulturore, sportive dhe të rinisë për komunën,

Organizon debate për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë në komunë,

Kujdeset për të arritura kulturore, sportive dhe rinore në komunë dhe mban evidencën mbi këto të arritura.

Zhvillon planin për mbështetjen e aktiviteteve kulturore sportive dhe rinore.

Kryen punët tjera të përcaktuara nga ligjet përkatëse dhe të caktuara nga Kryetari i Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të saja në fushën e veprimtarisë është përgjegjëse dhe obligohet;

Ushtron aktivitet të planifikuara, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale, kulturore të rinisë dhe të sporteve.

Propozon dhe përgatitë parallogaritë buxhetore të drejtorisë në kuadrin e organizatës buxhetore të administratës Komunale, dhe të njëjtën e bën publike, dhe ndarjen e tij për aktivitet kulturore, rinore dhe sportive si dhe do të përpilon rregullore për ndarje prioritare dhe proporcionale të buxhetit të saj për fushat e veprimtarisë që do ti mbulon.

Bënë organizimin dhe përkujdesjen për shënimin e datave me rëndësi dhe vlera të dëshmuara historike (Planin vjetor të punës për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën Hani i Elezit)

Organizon debate, tryeza me shtresat e shoqërisë civile dhe organet shtetërore me qëllim të avancimit, zhvillimit dhe promovimit, të fushës së kulturës, preokupimet, problematikën dhe aktivitetet e rinisë dhe të sporteve në të gjitha degët dhe disiplinat e tij.

Udhëheqë me përgjegjësi të lartë ligjore me arkivin Komunal dhe lëndën arkivore dhe përkujdeset për ruajtjen, konservimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë arkivore.

Udhëheqë me Qendrën Kulturore "Imri Curri" bibliotekën Komunale dhe palestrat sportive në hapësirat e Komunës Hani i Elezit.

Përpilon, rishikon dhe ndryshon punët dhe veprimet juridike të raporteve juridiko-civile kontraktuale, në lidhje me objektet e kulturës, rinis dhe sporteve.

I raporton kryetarit të Komunës për përgjegjësit dhe detyrat e drejtorisë si dhe bashkëpunon me drejtorit tjera të administratës Komunale dhe Kuvendin Komunal, si dhe organet e sigurisë në Komunë.

Përgatitë raporte të arsyetuara dhe të argumentuara kur kërkohet nga anëtarët e Kuvendit Komunal, apo KPF të Kuvendit (në formë pyetje-interpelancë-kuvendare) me miratim dhe autorizim të Kryetarit të Komunës.

Të krijoj relacione bashkëpunimi funksional dhe hierarkik me ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sporteve dhe të kërkoj mbështetje për projektet e drejtorisë në fushën e Kulturës, Rinis dhe Sporteve.

Të përkujdeset për sigurimin e resurseve njerëzore dhe materiale (financiare) për realizimin e programeve të rinisë.

Bënë licencimin e qendrave rinore dhe regjistrimin e grupeve, klubeve, ansambleve etj.

Kujdeset për trashëgimin kulturore dhe historike materiale të Komunës. (xhamit, shkolla muze, shtëpitë e banimit (të vjetra) dhe strukturat tjera që dëshmojnë histori - si burime materiale historike dhe së bashku me MKRS dhe donator kujdeset për mirëmbajtjen dhe restaurimin e tyre në përputhje me identifikimet e kësaj pasurie kulturore në PZHU, të Komunës së Hanit të Elezit.

Ushtron, dhe promovon dhe nxit bashkëpunimin, me qytete tjera të Republikës së Kosovës dhe me shtete tjera në përputhje me politikat jashtme të shtetit të Kosovës, për të mundësuar integrim të mirëfilltë kulturash dhe këmbim përvojash në interes të zhvillimit të kulturës në përgjithësi dhe integrimin kulturor të rinisë së Mërgatës sonë në diasporë.

Respektimi, hulumtimi dhe përkrahja dhe ndihma për asociacione, klube dhe shoqata dhe hulumtimi i individëve me aftësi fushat e kulturës dhe sportit dhe mbështetja e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Bashkëpunimin me drejtorinë e arsimit në lidhje me reformat dhe kushtet që mundë ti kenë të rinjtë (duke organizuar, gara, kuize dhe forma të tjera të aktiviteteve kulturore shkencore dhe sportive.

Organizon, anketa seminare dhe trajnime të ndryshme, me qëllim të njoftimit, promovimit dhe inkuadrimit të të rinjve kosovar në aktivitetet rinore evropiane e botërore.

Organizon fushata me rininë dhe me shoqërinë në përgjithësi për luftën kundër substancave psikotrope (drogës, duhanit) dhe fushata tjera nga preventiva shëndetësore në luftën kundër – HIV, prostitucionit dhe dukurive tjera negative në shoqëri.

Ushtron edhe autorizime dhe kompetenca të tjera në fushën e organizimit të punës në drejtori, krijimin dhe hartimin e akteve të brendshme për drejtorinë, si dhe bën fletëparaqitjet disiplinore dhe fletëparaqitjet tjera për nëpunësit e drejtorisë në rastet e shkeljeve të detyrave të tyre të punës dhe kodit të mirësjelljes në komisionin si dhe bënë vlerësimin e rezultateve në punë për shërbyesit civil të drejtorisë.

Ushtron edhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta dhe akte nënligjore qendrore apo komunale, si dhe duke u bazuar në udhëzimet strategjike të kryetarit të Komunës dhe të akteve të tij.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Mehmet Ballazhi, Kryetar i Komunës së Hanit Elezit Florim Shkreta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Hanit Elezit		
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë		
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha , Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së		
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 19.04.2023 020-020-320	
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë		
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Hanit Elezit		

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01/Nr.2457/2023 për shpalljen e interesit përgjithshëm të pronave të komunave

I miratuar më datë: 30.03.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Hanit Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2023, ka miratuar Vendimi 01/Nr.2457/2023 për shpalljen e interesit përgjithshëm të pronave të komunave.

MAPL, konstaton së në Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Hanit Elezit për të shpallë më interes të përgjithshëm duhet të miratohet duke votuar secilën pronë ndaras. Vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë të Kuvendit të Komunës ashtu siç përcaktohet më Nenin 26 paragrafi 6 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Hanit Elezit, që të ndërmerr veprime ta rishqyrtoj aktin 01/Nr.2457/2023, në mënyrë që për secilën pronë të miratoj vendim të veçantë dhe të harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 3880 2023

DATA :	10.05.2023
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
CC :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Plotësim-ndryshim i vendimit nr 01/Nr 1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023

Të nderuar,

Përmes kësaj kërkesë, ju njoftojmë për bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të vitit 2022 dhe bartjen e tyre në vitin 2023, nëpër kategoritë ekonomike dhe nën-programet buxhetore të komunës së Hanit të Elezit.

Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2022 kanë qenë në shumë prej **358,827.93 €**, prej tyre janë të shpenzuara **243,822.54 €**, mbetja nga të hyrat e vitit 2022 është **115,005.39 €**.

Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2022 janë në shumën prej **115,005.39 €**, të cilat i bartim në vitin 2023 dhe i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon:

- ✓ mallra dhe shërbime në shumë prej **8,704.33€**,
- ✓ subvencione dhe transfere në shumë prej **1,033.00 €** dhe
- ✓ shpenzime kapitale në shumë prej **105,268.06 €**.

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime

- ✓ Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111), shuma prej **3,000.00 €**,
- ✓ Administrata e Përgjithshme (16335), kodi funksional (0133) shuma prej **2,500.00 €**,
- ✓ Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444), kodi funksional (0320), shuma prej **3,204.33 €**.

Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere

- ✓ Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej **1,033.00 €**.

Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale

- **Parandalimi dhe Inspektimi i zjarrit (18444):**

Parandalimi dhe Inspektimi i zjarrit (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej **15,000.00 €**, në këto projekte:

“Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka në Seçishtë” (51616) në shumë prej **10,000.00 €**,

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe vendosja e ujëmatësve në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit” (53773), në shumë prej **5,000.00 €**.

- **Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480):**

Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej **72,607.33 €**,

“Rregullimi i parkut në rrugën “Isa Berisha” (asfaltim, trotuar, ndriçim publik, gjelbërim)”, kodi projektit (51085), në shumë prej **25,000.00 €**.

“Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik”, kodi i projektit (53471), në shumë prej **22,607.33 €**.

“Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik”, kodi i projektit (53484), në shumë prej **25,000.00 €**.

- **Arsim fillor, i mesëm, i ulët (94020):**

Arsim fillor, i mesëm, i ulët (94020), kodi funksional (0912), në shumë prej **17,660.73 €**, në projektin:

“Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML – Dardania, SHFMU – Ilaz Thaçi, SHFMU – Kështjella e Diturisë dhe SHMFU – Veli Ballazhi (53774), në shumë prej **17,660.73 €**.

Tabela 1. Shpërndarja e mjeteve nëpër nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike

Kodi i nënprogramit	Nën-Programet Buxhetore	Mallrat dhe shërbimet	Subvencionet dhe transferet	Investime Kapitale	Totali
16035	Zyra e Kryetarit	3,000.00	1,033.00	-	4,033.00
16335	Administrata e Përgjithshme	2,500.00	-	-	2,500.00
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarrit	3,204.33	-	15,000.00	18,204.33
66480	Planifikimi urban dhe inspeksioni	-	-	72,607.33	72,607.33
94020	Arsim fillor, i mesëm, i ulët	-	-	17,660.73	17,660.73
	Totali	8,704.33	1,033.00	105,268.06	115,005.39

Tabela 2. Shpërndarja e mjeteve nëpër nën-programet buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale, në projektet si vijon:

	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE 2023	105,268.06
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarrit	15,000.00
51616	Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka në Seçishtë	10,000.00
53773	Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe vendosja e ujëmatësve në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	5,000.00
66480	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni	72,607.33
51085	“Rregullimi i parkut në rrugën “Isa Berisha” (asfaltim, trotuar, ndriçim publik)	25,000.00
53471	Shtimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	22,607.33
53484	“ Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	25,000.00
94020	Arsim fillor, i mesëm, i ulët	17,660.73
53774	Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML – Dardania, SHFMU – Ilaz Thaçi, SHFMU – Kështjella e Diturisë dhe SHMFU – Veli Ballazhi	17,660.73

Me respekt,

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJA E MJEDISIT

INFORMATË MBI GJENDJEN NË MJEDIS NË HAN TË ELEZIT PËR VITIN 2022

Hani i Elezit
05.05.2023

H Y R J E

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit (DUKMM) gjegjësisht Komuna e Hanit të Elezit, bazuar në mundësitë dhe kapacitetet e saja profesionale dhe financiare, në vazhdimësi përcjellë dhe ndërmerr masa për parandalimin dhe përmirsimin e gjendjes mjedisore siq janë: investimet kapitale publike të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e ambientit, ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë pikave grumbulluese, pengimin e hedhjes së mbeturinave inerte në lum dhe prrocka, kontrollimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomik, gurëthyesve si dhe ndotësve tjerë. Pavarsishtë kësaj, vitin 2022 ndotja e ambientit është pa ndryshime të mëdha në raport me ndotjen e vitit 2021.

N D O T J A E A J R I T

Ndotja e ajrit ndodhë kur në ajër lirohen substanca në sasi që mundë të dëmtojnë shëndetin e njerzve, kafshëve dhe bimëve ose mundë të shkaktojnë dëme materiale. Është e njohur se ndotësit kryesor të ajrit në Han të Elezit janë fabrika për prodhimin e çimentos SharrCem, numri i madh i veturave dhe mauneve në qarkullim sidomos në magjistralen Prishtinë-Hani i Elezit, përdorimi në masë të madhe i masës drusore për ngrohje gjatë sezonit dimëror, gurëthyesit etj.

Përndryshe, monitorimi i cilësisë së ajrit në Han të Elezit, bëhet nga IHMK (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës) përmes stacionit për monitorim i vendosur në oborrin e shkollës fillore “Ilaz Thaçi”. Ky stacion është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin urban dhe përmes tij monitorohen këto parametra: dioksidi i sulfurit (SO₂), dioksidi i azotit (NO₂) ozoni(O₃), monoksidi i karbonit (CO), grimcat e imta PM10 dhe PM2.5. Po ashtu monitorimi i ajrit bëhet edhe nga stacioni për monitorim i Sharrcem, i vendosur në hapësirat e brendshme të saja. Ky stacion është reprezentativ për cilësinë e ajrit në sfondin industrial dhe përveç parametrave të lartpërmendur bënë matjen edhe të Oksideve të Squfurit (SO_x), Oksidet e Azotit (NO_x), si dhe pluhurit qe emetohet nga oxhaku i furrës, ftohësi i klinkerit dhe mullinjtë e çimentos. Sharrcem, në baza të rregullta mujore, raportet e monitorimit të ajrit ia përcjellë Drejtorisë së Mjedisit respektivisht inspektore Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërkaq MMPH-ja këto raporte i publikon në faqen e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK).

Më poshtë po japim Normat e Cilësisë së Ajrit sipas udhëzimit administrativ Nr.02/2011, si dhe rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit nga stacioni i IHMK.

Normat e cilësisë së ajrit sipas udhëzimit administrativ Nr.02/2011

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare) μ/m^3	Tejkalimet e lejuara për ditë brenda vitit
NO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore për mbrojtjen e vegjetacionit	μ/m^3	30	Nuk parashihet
SO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimales 8 orëshe për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m ³	10	Nuk parashihet
PM ₁₀ PM _{2.5}	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	50	35
	Vlera limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	40	Nuk parashihet
	Viti kalendarik	μ/m^3	25	Nuk parashihet
O ₃	Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	μ/m^3	120	Nuk parashihet
	Pragu i informimit	μ/m^3	180	Nuk parashihet
	Pragu i alarmit	μ/m^3	240	Nuk parashihet

Indexi i Cilësisë së Ajrit sipas standardeve të BE-s

Cilësia	Shumë e mirë	E mirë	E moderuar	E pashëndetshme	E rrezikshme për shëndetin
Grimcat e pluhurit më të vogla se 2.5 μm (PM _{2.5})	0-10	10-20	20-25	20-50	50-800
Grimcat e pluhurit më të vogla se 10 μm (PM ₁₀)	0-20	20-35	35-50	50-100	100-1200

Dioxidit i azotit (NO ₂)	0-40	40-100	100-200	200-400	400-1000
Ozoni (O ₃)	0-80	80-120	120-180	180-240	240-600
Dioksidi i Sulfurit (SO ₂)	0-100	100-200	200-350	350-500	500-1250
Niveli i indexit i bazuar në përqëndrimin e ndotësve shprehur në µg/ ³					

Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit nga stacioni i IHMK

Dioksidi i Sulfurit SO₂ (µg/m³)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Vlera mesatare vjetore e emetimit	8.5 µg/m ³	5.3 µg/m ³
Muaji me vlerën mesatare më të lartë	16 µ/m ³ (dhjetor)	10 µ/m ³ (dhjetor)
Muaji me vlerën mesatare më të ulët	1.9 µ/m ³ (tetor)	2.7 µ/m ³ (maj)

Monoksidi i Karbonit CO (µg/m³)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Vlera mesatare vjetore e emetimit	0.35 µ/m ³	0.32 µ/m ³
Muaji me vlerën mesatare më të lartë	0.7 µ/m ³ (shkurt)	1 µ/m ³ (gusht)
Muaji me vlerën mesatare më të ulët	0.1 µ/m ³ (shkurt-korrik)	0.1 µ/m ³ (prill)

Dioksidi i Azotit NO₂ (µg/m³)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Vlera mesatare vjetore e emetimit	16.29 µ/m ³	15.4 µ/m ³
Muaji me vlerën mesatare më të lartë	16.29 µ/m ³	23.12 µ/m ³ (dhjetor)
Muaji me vlerën mesatare më të ulët	12.5 µ/m ³ (qershor)	9.8 µ/m ³ (qershor)

Ozoni (O₃) (mg/m³)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Vlera mesatare vjetore e emetimit	60.28 mg/m ³	57.5 mg/m ³
Muaji me vlerën mesatare më të lartë	160.6 mg/ ³ (korrik)	91.2mg/ ³ (korrik)
Muaji me vlerën mesatare më të ulët	30.9 mg/m ³ (dhjetor)	22 mg/m ³ (dhjetor)

Grimcat PM10 ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Vlera mesatare vjetore e emetimit	16.95/ m^3	19.3 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
Muaji me vlerën mesatare më të lartë	35.3 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (nëntor)	30 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (dhjetor)
Muaji me vlerën mesatare më të ulët	3.9 (gusht)	10.8 (shtator)
Vlera maksimale për një ditë	86.6 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	68 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (korrik)
Data e vlerës maksimale e mesatares ditore	24.12.2021viti	23.12.2022viti

Grimcat PM2.5 ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)

Emertimi	Viti 2021	Viti 2022
Vlera mesatare vjetore e emetimit	13.52 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	13.9 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
Muaji me vlerën mesatare më të lartë	26.2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (shkurt)	26.3 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (dhjetor)
Muaji me vlerën mesatare më të ulët	3.6 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (gusht)	7.5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (korrik)
Vlera maksimale për një orë	132.3 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	94.4 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
Data e vlerës maksimale	23.12.2021viti	23.12.2022viti

Vlerësimi i cilësisë së ajrit gjatë vitit 2021, bazuar në të dhënat e monitorimit nga IHMK

Ky vlerësim përfshinë vlerat mesatare vjetore dhe të njejtat janë krahasuar me vlerat maksimale të lejuara (VLM) sipas U.A 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit si dhe krahasimin me vitin paraprak. Nga të dhënat për matjen e përqendrimit të ndotësve në ajër mund të konstatohet se vitin 2022, tejkallime të vlerës maksimale të lejuar janë regjistruar te O_3 (Ozoni) dhe ate muajin mars gjithësejtë 5 orë me tejkallime, në muajin maj 3 orë me tejkallime, qershor 5 orë me tejkallime, korrik 62 orë me tejkallime dhe mujin gushtë 28 orë. Vlera maksimale për një orë është regjistruar me dt.24.07.2022 dhe ate 175.5 mg/m^3 . Për sa i përket PM10 në muajin janar janë regjistruar 3 ditë me tejkallime si dhe muajin dhjetor 4 ditë me tejkallime. Vlera maksimale për një ditë është regjistruar me dt.23.12.2022 dhe ka arritë 668 $\mu\text{g}/\text{m}^3$. Ndërkaq sa i përketë PM_{2.5} vlerat më të larta janë shënuar në muajt Nëntor, Dhjetor, Janar dhe Shkurt (vlera maksimale për një orë është shënuar me dt. 23.12.2022 dhe ka arritur në 94.4 $\mu\text{g}/\text{m}^3$). Vlerat e shënuara pothuajse janë dyfishi i vlerave limite të përcaktuar me U/A 02/2011 dhe bazuar në indexin e cilësisë së ajrit, këto vlera kategorizohen si të pashëndetshme. Këto vlera pak sa më të larta të përqendrimit të këtyre ndotësve në ajër kryesishtë i atribuohen ndotjes nga SharrCem-i, ngrohjes me masë drusore, qarkullimit të dendur të automjeteve si dhe kushteve të pafavorshme meteorologjike. Përndryshe vlerat mesatare vjetore të SO_2 , CO, NO_2 , O_3 , PM_{2.5} dhe PM₁₀ për vitin 2022 kanë qenë në vlerat normale kufitare të lejuara me U/A nr.02/2011.

NDOTJA E TOKËS dhe UJIT

Për sa i përket ndotjes së tokës dhe ujit, nuk ka ndryshime thelbësore në raport me vitin 2021. Edhe më tutje territori i Hanit të Elezit (toka) është e kontaminuar nga ndotja afatgjate si rezultat i emetimit të pluhurit dhe substancave tjera të dëmshme nga fabrika e çimentos për më shumë se tetë dekada të funksionimit të saj. Edhe më shumë të dëmshme janë mbetjet e azbestit të përhapura gjithëandej Hanit të Elezit e më së shumti në brigjet e lumit Lepenc, si rezultat i operimit të Sharr-Sallonit në vitet e tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta.

Për sa i përket ndotjes së ujit edhe më tutje shqetësuese është ndotja e lumit Lepenc nga mbeturinat e patrajtuara të sistemit të ujrave të zeza e kombinuar me ndotjen kimike nga industrinë në këtë regjion. Përndryshe ndotja e lumit Lepenc renditet në kategorinë dy dhe tre nga katër kategoritë e klasifikimit.

SEKTORI I MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë bërë inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë si dhe një gjobë mandatore. Sektori i Mjedisit në vazhdimësi ka monitoruar ndotjen nga “Sharrcem” ku me shkresë zyrtare i jemi drejtuar “Sharrcem”-it me ç’rast kemi shprehë paknaqësitë tona dhe të qytetarëve lidhur me ndotjen e ajrit ku kemi kërkuar që të marrin masa për parandalimin e ndotjes së ajrit si dhe kemi njoftuar Inspektorët e MMPHI-së dhe kemi inspektuar së bashku. Sektori i Mjedisit ka bërë identifikimin e deponive ilegale dhe në bashkëpunim me kompaninë “Pastrimi” është bërë pastrimi dhe eliminimi i tyre. Po ashtu me një aksion për pastrim të organizuar nga Komuna kemi shënuar dhe Ditën Ndërkombtare të Tokës. Në periudhën raportuese sektori i mjedisit ka lëshuar dy Leje Mjedisore Komunale, prej të cilave njera ndërlidhet me një ndërtim të kategorisë I.

Pjesë e kësaj informate është dhe raporti i SharrCem.

Kjo informatë është përpiluar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i ndihmuar nga zyrtarja për Mjedis Fatbardha Bushi.

Hani i Elezit
Maj, 2023

Drejtori i DUKMM
Nexhmedin Daci



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

3861

Nr.06/___2023

DATË:	10.05.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Informatë mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2022 si dhe raporti i SharrCem

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse po ju përcjellim Informatën mbi gjendjen në mjedis në Han të Elezit për vitin 2022 si dhe raportin e SharrCem për mjedisin po ashtu për vitin 2022.

Me Respekt.



2022

RAPORTI VJETOR PËR MJEDISIN

SHARRCEM

TITAN CEMENT GROUP

Përgjegjësitë Mjedisore në Sharrcem

Sharrcem-i kujdeset për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Për t'i shërbyer më së mirë këtij qëllimi, Sharrcem-i gjithashtu kujdeset dhe investon në edukimin si dhe ruajtjen e një mjedisi të pastër, të sigurt dhe të qëndrueshëm. Si pjesë e punës sonë të përditshme ne përpiqemi që të ofrojmë dhe sigurojmë një menaxhim sa më efektiv të mjedisit, duke vepruar në përputhje me standardet mjedisore, duke minimizuar ndotjen dhe duke marrë masat e nevojshme në parandalimin e dëmtimit të mjedisit. Si pjesë e angazhimit të TITAN Group, duke "për të bërë më pak dëm të bëjmë më të mirën", menaxhimi dhe përmirësimi i performancës mjedisore është çelësi kryesorë për të nxitur qëndrueshmërinë, edhe përgjatë rrethanave jashtëzakonisht të vështira ekonomike.

Ne kemi për qëllim që të përmirësojmë vazhdimisht punën tonë duke rritur vetdijen tonë ndaj sfidave të mëdha me të cilat përballlet Sharrcem-i drejt qëndrueshmërisë mjedisore. Ne vazhdimisht përpiqemi që të krijojmë menaxhim efektiv mjedisor, duke matur dhe monitoruar performancën tonë, dhe vazhdimisht kërkojmë që të përmirësojmë dhe në të njejtën kohë të promovojmë praktikatat më të mira në fabrikën tonë duke angazhuar palet e interesit, në transparence të plotë nëpërmjet raportimit publik të performancës dhe progresit. Ne gjithashtu angazhohemi me përkushtimin tonë që në vashdimësi të jemi në hap me kohën përmes trajnimeve të shumta, duke integruar ato në procesin e zhvillimit të biznesit. Sharrcemi operon nën kushtet e lejes së Integruar (IPPC) që nga viti 2014 dhe i ka të përmbushura të gjitha kërkesat sipas planit të përputhshmerive të lejes së Integruar.

Përmbledhje 2022

Mbledhja Vjetore e Komitetit Mjedisor (CEC)

Komiteti mbledhet çdo vit për të analizuar, diskutuar dhe miratuar programet mjedisore, planet e veprimit, raportin vjetor dhe treguesit e performancës mjedisore për vitin përkatës.

Në vazhdim do të paraqiten disa nga aktivitetet tona kryesore për vitin 2022.

Internal Audit - Sipas orarit të grupit për auditimet periodike të performancës mjedisore, fabrika e Sharrcem-it u auditua nga 8 deri në 11 Nëntor 2022.

Asnjë jo konformitet nuk është gjetur.

Auditimi i ricertifikimit - Auditimi i ricertifikimit të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor u mbajt në Nëntor, 2022 sipas standardit EN ISO 14001:2015, nga kompania e jashtme certifikuese EUROCERT.

Gjatë auditimit, veprimet e ndërmarra për gjetjet e evidentuara gjatë auditimit të mëparshëm për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor, përmirësimi i vazhdueshëm i tij është vlerësuar shumë.

Asnjë jo konformitet nuk është gjetur.

.

Përmirësimet e vazhdueshme:

Në kuadër të monitorimeve dhe raportimeve për vitin 2022 përveq monitorimit të vazhdueshëm të emisioneve nga burimet kryesore, në baze periodike është bërë monitorimi i cilësisë së ajrit dhe zhurmave në mjedis në perimetrin e fabrikes dhe minierat Dimce dhe Seqishte .

Në baza periodike është bërë edhe monitorimi i cilësisë së ujrave nentoksor dhe ujrave shkarkues nga impianti për trajtimin e ujrave të zeza.

Sistemi për monitorimin e vazhdueshëm të emisioneve

Përtej kërkesave ligjore, kompania vullnetarisht vendosi të krijojë dhe operojë një sistem të monitorimit të vazhdueshëm të Emisioneve (CEMS), që nga fillimi i vitit 2013.

Nje kerkese e tille qe nga viti 2014 eshte e percaktuar edhe me kushtet e lejes se Integruar .

- **CEMS** verifikohen në mënyrë periodike për sigurimin e cilësisë së të dhënave, nga palët e treta.
- **Të gjitha** instrumentet për CEMS janë të kalibruar dhe kontrollohen në bazë të standarteve EN 14181 dhe BS EN 13284-01.


Që nga viti 2019 është bërë zëvendësimi i softwerit eksistues MEAC 2000 me softwer më të avancuar (MEAC 300) për përpunimin e të dhënave të emisioneve, sistem që gjeneron çdo kohe automatikisht dhe në mënyrë të pavarur vlerat e emisioneve dhe siguron cilësinë dhe pavarësinë. SHARRCEM vepron në përputhje me Teknikat më të mira të mundshme (BAT), për reduktimin e emisioneve për industri të cimentos, Direktiva 2010/75 / BE, dhe ligjit të IPPC – Lejes së Integruar .

EMETIMET NË AJËR

Oxidet e Sqfurit(SOx) dhe oksidet e azotit (NOx)

Prania e sqfurit (S), në lëndët e dhe në lëndën djegëse janë burimet kryesore të emisioneve SOx . Emisionet e SOx janë shumë të ulëta, për shkak të përqendrimit të ulët të Sqfurit në lëndën djegëse dhe lëndët e para. Në bazë rezultateve të matjeve nga sistemi i monitorimit të vazhdueshëm të instaluar që nga viti 2012, është paraqitur përqendrimi mesatar vjetor i SOx dhe NOx nga furra rotulluese për gjatë tri viteve të fundit.

Djegia në temperatura të larta është si rezultat i pranisë së dioksideve të azotit në emisione. Në vitin 2022 emisionet e përgjithshme NOx në SharrCem ishin nën pragun e kufirit (VKE) të përcaktuara nga legjislacioni vendor dhe të kërkesave të IPPC. Për shkak të lëndës së parë të kufizuar (Mergele) në minierën e Dimces, cilësia aktuale e këtij materiali ka një modul më të lartë silikat i cili kërkon temperatura më të larta për krijimin e fazës së lëngshme në furrën rrotulluese, përkatësisht sasi më të larta të lëndës djegëse, duke rezultuar në rritjen e emisioneve të NOx .



PLUHURI

Kemi dy burime të emisioneve të pluhurit në fabrikën e çimentos, përkatësisht:

a. Burimet e emisioneve të pluhurit të emituara nga oxhaqet e furrës, ftohësi e klinkerit dhe mullijte e çimentos. Vlerat e matura tregojnë se emitimet nga keto burime janë dukshëm nën vlerat kufitare. Masat për reduktimin e emisioneve të pluhurit nga burimet kryesore janë paraqitur si më poshtë:

filterat me thasë - përdoren dhe mirëmbahen siç duhet për të siguruar nivele të ulëta të pluhurit.

Transporti bëhet nëpërmjet shiritave transportues të mbuluara dhe të mbyllura.

Statistikat tregojnë se nivelet janë të qëndrueshme dhe nuk tregojnë ndonjë tendencë të tejkalimit të kufirit apo të rritjes së shkarkimeve.

b. Pluhuri transient - është totali i grimcave të emetuara nga burime jo të përcaktuara dhe jo të vazhdueshme, por është e lidhur me kushte të caktuara dhe aktivitete si era, ngarkim, shkarkimit, aktiviteteve për mirembajtje.

Figure 1 Emisionet e pluhurit nga Furra – Kiln [mg/Nm³]




Figure 2 Emisionet e Pluhurit nga ftohësi i klinkerit [mg/Nm³]





Figure 3 Emisionet e Pluhurit nga mulliri i çiment



Monitorimi i Cilësisë së ajrit të Mjedisit

Plani i veprimit për redukimin e pluhurit transient është kompletuar me mbylljen e depos së clinkerit dhe materialeve të para.

Redukimi i burimeve të zhurmes në mjedis është përmbyllur përmes aktiviteve të parapara me planin e veprimit. Nga rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Hanin e Elezit përmes sistemit të instaluar nga ana e Ministrisë dhe i monitoruar nga instituti hirometerologjik i Kosovës gjatë vitit kalendarik 2022 rezultojnë të dhënat për parametrat kryesor të cilësisë së ajrit me qka vërehet se nuk ka pasur tejkalime të theksuara gjatë vitit 2022.

Ndërkaq nga vetë monitorimi i cilësisë së ajrit në perimetrin e fabrikës dhe të minierës gjithashtu vërehet se nuk ka pasur tejkalime të parametrave kryesor të cilësisë së ajrit.

Table: 1

QUALITETI I AJRIT TE MJEDISIT – MOMITORIMI I PERIMETRIT TE FABRIKES			
PERIMETERI FABRIKES	2021	2022	ELV & IPPC (mg/m ³)
PM ₁₀ (mg/m ³)	0.043	0.040	0.05
PM _{2.5} (mg/m ³)	0.021	0.020	0.025
NO ₂ (mg/m ³)	0.020	0.019	0.04
SO ₂ (mg/m ³)	0.011	0.010	0.125
O ₃ (mg/m ³)	0.027	0.024	0.12
Zhurma dB)	63	63.5	70 (dB)

Përmirësimet /plani i veprimit - Duke i marrë parasysh vërejtjet e palëve të interesit në lidhje me shqetësimet mjedisore, Sharrcem harton planet e masave për adresimin e këtyre vërejtjeve përmes programeve të përmirësimeve në mjedis.

MATJET E QASTIT FURRA DHE MULLIRI I LËNDËS

Edhe gjatë vitit 2022 matjet e qastit (Spot) në oxhakun e furrës rrotulluese dhe mullirin e lëndës gjatë dy regjimeve punuese të furres janë kryer për këto parametra:

N₂O; POPs (Diox. & Furan); HCl; HF; Hg; (Cd and Tl); metalet e renda (Sb, As, Pb, Cr, Co, Cu, Mn, Ni, V); TOC.

Kalibrimi i paisjeve për matje të vazhduar në furrën rrotulluese, ftohesin e klunkerit dhe mullinjve për bluarje është kryer në bazë të matjeve krahasuese nga kompania e certifikuar; RI-EPM Shkup.

Vlerat e matjeve janë të presentuara ne Tab. 2

Tabela :2

MATJET E QASTIT – OXHAKU I FURRES DHE MULLIRI I LËNDËS			
	2021 @10%O2 dry mg/Nm ³	2022 @10%O2 dry mg/Nm ³	IPPC ELV @10%O2dry mg/Nm ³
Average N ₂ O	5.4	3.4	Na
Average HF	1.0	1.0	1.0
Average HCl	4.1	2.1	10
PCDD+PCDF (ng/Nm ³)	0.0012	0.0011	0.2
Total Heavy metals in (mg/Nm ³)	0.362	0.41090	0.6
Cd+Tl (mg/Nm ³)	0.0011	0.00106	0.06
Hg (mg/Nm ³)	0.000378	0.00038	0.06

MENAXHIMI I UJRAVE

Investimet e menaxhimit të ujit në sistemin e riciklimit të ujit dhe përmirësimin e rrjeteve ekzistuese të ujit kanë çuar në përdorimin më efikas të ujit, ndërsa zhvillimi dhe implementimi i sistemeve të menaxhimit të ujit ka përmirësuar monitorimin e përgjithshëm dhe mundeson raportimin mbi përdorimin dhe shfrytëzimin e ujit ne baza të qëndrueshme.

Figure 4 Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujrave për prodhim të çimentos




Figure 5 Shpenzimi specifik i ujit për prodhimin e çimentos [l/tcementitious]





Figure 6 Shkarkimi total i ujrave nga impianti për trajtim (WWTP)



Cilësia e ujrave të shkarkuar

Impianti për trajtimin e ujrave të zeza është në funksion të plotë që nga Marsi i vitit 2016. SHARRCEMI monitoron cilësinë e ujrave shkarkues 4 herë në vit përmes laboratorit të akredituar. Impianti për trajtimin e ujrave të zeza ka qenë në funksion për gjatë gjithë vitit 2022 dhe nuk ka pasur ndonjë problem në funksionimin e tij. Parametrat monitorues të shkarkimit të ujrave të trajtuar kanë qenë nën vlerat e lejuara në përputhje me UA 30/2014 dhe janë të paraqitura në Tab Nr.3. Gjithashtu në baza periodike është bërë edhe monitorimi i cilësive së recipientit - perrocka e Dimces në cilën shkarkohen ujrave të trajtuar nga impianti dhe vlerat e monitorimit janë të paraqitura në tabelën Nr.4

Impianti per trajtim (WWTP) -Parametrat e qaulitetit		VK sipas –UA 30/2014	Qualiteti para trajtim	Qualiteti pas trajtim
			2022	
pH		6-8.5	8.82	8.05
Chemical Oxygen Demand (COD)	mg/l O ₂	125	322.00	80.30
Biochemical Oxygen Demand (BOD ₅)	mg/l O ₂	25	194.5	22.85
Total Suspended Solids (TSS)	mg/l	60	218.75	34.65
OIL and Grease	mg/l	10	3.86	0.01
TOC	mg/l	40	127.55	21.10

CILESIA E RECIPIENTIT PERROI I DIMCES 2022		VK sipas –UA 30/2014	Parametrat e cilesise se recipientirt Dimce
Temperatura	°C		19.05
pH		6-8.5	8.34
Chemical Oxygen Demand (COD)	mg/l O ₂	125	6.85
Biochemical Oxygen Demand (BOD ₅)	mg/l O ₂	25	17.65
Total Suspended Solids (TSS)	mg/l	60	9.85
OIL and Grease	mg/l	10	nld
TOC	mg/l	40	5.30

MENAXHIMI I MBETJEVE & shfrytëzimi i tyre

Mbetjet e ngurta ruhen përkohësisht në vende të veçanta të përcaktuara në afërsi të vendeve ku gjenerohet brenda Fabrikës. Magazinimi i tillë kryhet në kuti të posaçme në kontejnerë ose vende të destinuara dhe të shënuara / etiketuara në mënyrë specifike për secilën mbetje. Varësisht nga lloji i mbetjeve të ngurta në hapësira të veçanta të cilat janë të kufizuara me qëllim të mbrojtjes nga rrjedhjet që mund të shkaktonin në ujë dhe tokë.

Mbeturinat barten dhe largohen nga Fabrika nga nënkontraktorët/pala e tretë e licensuar. Këta nënkontraktorë ofrojnë shërbime lidhur me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

SHPJEGIM:

Mbetjet e përziera komunale - largimi nga kompanija e licensuar – landfill ; Scrap largimi nga kompanija e licensuar - riciklohen ; tulla nga murimi i furrës – deponohen në minirë ; thasë të shkyer të çimentos -largimi nga kompanija e licensuar - riciklohen ; Mbeturinat nga Demolimi – Shrytezohen për rimbushjen e minierës; ambalazhet plastike- largimi nga kompanija e licensuar – riciklohen. Paleta drurit ripërdoren nga ana e kompanisë për furnizim me paleta për prodhime të gatshme.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë sasi të mbetjeve të gjeneruara përgjatë vitit 2022, të cilat janë larguar nga fabrika përmes kompanive të licensuara për menaxhimin e mbetjeve për kategori të ndryshme dhe sasia e mbetjeve të shfrytëzuara në Sharrcem si lëndë të para alternative.

Table :5

GJENERIMI I MBETJEVE								
VITI	Mbetje të përziera komunale (t/y)	Scrap (t/y)	Tulla për murim të furrës (t/y)	Thasë të shkyer të cem. (t/y)	Leter dhe karton (t/y)	Mbetje nga demolimet (t/y)	Paleta të drurit (m³/y)	Vajra të përdorur (t/y)
Kodi i mbetjeve	200108	170405	101308	/	150101	885032	150103	130205*
2022	47.79	211.82	233.2	15.4	2.5	466.4	3.86	0.5

Table:6

SHFRYTËZIMI I MBETJEVE				
VITI	FLY ASH (t/y)	BOTTOM ASH (t/y)	PYRITE ASH (t/y)	REFRACTORY BRICKS (t/y)
Kodi i mbetjeve	10 01 02	10 01 01	/	101308
2022	96926.50	9,944.12	2,393.67	0

CSI dhe Ndryshimet Klimatike

TITAN Group Fusha 3 e GHG Emissionev 2022 – Sharrcem

Për herë të parë që nga viti 2020, me kërkesë të TITAN Grupes është filluar me monitorimin e emetimeve dhe raportimin e fushës 3 të emetimeve të CO₂ dhe grumbullimi i të dhënave është raportuar për vitin 2022 në Raportin Vjetor të Integruar të Grupit. Për më tepër, ata do të jenë ndër KPI-të që do të verifikohen nga auditori i jashtëm (në nivel Grupi).

Fusha 3 Emetimi i CO₂ është referuar në burimet e mëposhtme:

Emetimet që lidhen me:

- Mallra dhe shërbime të blera
- Aktivitetet e lidhura me karburantin dhe energjinë
- Transporti dhe shpërndarja në rrjedhën e sipërme
- Transporti dhe distribucioni në rrjedhën e poshtme

Fusha 1 e CO₂ - Emetimet në lidhje me:

- Lenden e pare, lendet e paperpunuara
- Djegia e karburantit (përfshirë furrën, dhe pajisjet percjllëse)

Fusha 2 e CO₂ - Emetimet në lidhje me:

- Furnizimin me energji Elektrike
- Fushëveprimi 1 dhe fushëveprimi 2 i Emetimeve të CO₂ nga industria e çimentos është e rregulluar në përputhje me protokollin WBSCD - CSI per CO₂ versioni 3.0 per industrinë e çimentos në nivel të Grupit Titan.

Figure 7 Emisionet totale të CO₂ nga fabrika e cimentos




Figure 8 Hargjimi specifik i nxehtesise për prodhim të clinkerit




Figure 3 Hargjimi specifik i energjise elektrike per prodhim te cimentos





Figure 9 Emisionet specifike te CO2 per produkte te cimentos

**Komente:**

- Rritja e emisioneve totale të CO2 lidhet me rritjen e prodhimit në fabrikën tonë.
- Emisionet specifike të CO2 për produkte të cimentos është rritur sepse këtë vit kemi pasur më pak klinker të importuar.

Plani i Rehabilitimit të Minierës së Mergeles, DIMCE

MENAXHIMI I NDIKIMEVE NË TOKË – REHABILITIMI I MINIERES

Miniera e Mergeles- Dimce - Objektivat:

Faza e operimit : Rehabilitimi progresiv i etaxhave të shfrytëzuara me aplikimin e rimbushje me dhe si dhe mbjelljen e fidaneve .


Pas vendimit për zgjerimin e etaxhave në lindje të minieres për shfrytëzimin sa më racional te lendes se pare, plani progresiv i rehabilitimit të minieres së mergeles ne Dimce (plani rehabilitues 15 vjeçar) do të vazhdojë vitin e ardhshëm. Përqindja aktuale (%) e minierave të rehabilituara/të afektuara është rreth 23%

Deri më tani janë mbjellë më shumë se 1200 fidane të reja, që nga fillimi i programit të rehabilitimit të guroreve në 2014.

Faza pas mbylljes: Kthimi i sipërfaqes së përgjithshme në komunitetet lokale pas mbushjes dhe nivelimit të sipërfaqes së gurores në nivelin +375.

Miniera e gurit gëlqeror në Seqishtë :

Miniera e gurit gëlqeror në Seqishtë funksionon për nevojat e uzinës Sharrcem e cila është në fazën fillestare të shfrytëzimit, ka Leje Mjedisore të lëshuar nga MMPH në dhjetor 2018 për një periudhë 5 vjeçare. Rehabilitimi teknik i etaxhave do të bëhet pas zgjerimit të tyre në zonat për të cilat do të aplikohet një leje e re shfrytëzimi gjatë vitit 2022.



Performanca e ESG (Qeverisja Mjedisore dhe Sociale) 2022

Për sa i përket dekarbonizimit, janë bërë përpjekje për optimizimin e portofolit të produkteve, duke u fokusuar në prodhimin e produkteve me klinker më të ulët dhe përgatitjen e një lloji të ri çimentoje me përmbajtje më të ulët klinker, e cila është testuar teknikisht me sukses dhe ka qenë në treg që nga korriku 2021. Ndikimi i plotë pozitiv do të jepet gjatë viteve në vijim. Për më tepër, për performancën mjedisore, duhet të theksojmë se të gjitha emetimet mbahen shumë më poshtë se nivelet e lejes së integruar.

Vizitë e ekipit të ekspertëve të Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA)

MMPH me ekipin e ekspertëve të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) do të qëndrojnë në Kosovë për përgatitjen e fazës së dytë të Projektit, të mbështetur nga JICA,

“Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës në vitin 2022. Në kuadër të këtij projekti ishte vizita në kompanitë kryesore industriale që operojnë në vend, të cilat ekzekutojnë sistemin e monitorimit të emetimeve në ajër, dhe zbatimin e standardeve mjedisore. Prandaj, Sharrcem u zgjodh si kompani shembull që është e pajisur me Leje Mjedisore të Integruar (IPPC).

